

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Minir Hoti, dhe sekretaren juridike Fatmire Podvorica, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. N. B. nga fshati B., Komuna e P., për shkak të veprave penale Vjedhje Pylli nga neni 358 par.1 dhe par.2 KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.nr.2240/2013 e dt.25.06.2013, PP.nr.4173/2014 e dt.15.06.2015, PP.II.nr.1280/2015 e dt. 13.01.2016, PP.nr.3748 /2013 e dt.04.07.2013, PP.nr.2243/2013 e dt.25.05.2014, PP.nr.7699/14 e dt. 21.11.2014 PP/n.1138/16 e dt.18.03.2016 në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur në praninë e Prokurorit të shtetit Fatmir Behrami nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe të pandehurit B. B., të njëjtën ditë më datën 26.09.2016 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **B. B.**, nga babai N., dhe nënës H. e vajzërisë S., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin P., Komuna e P., tani me vendbanim në fshatin B., Komuna e P., ku edhe tani jeton, nr. personal *numër personal...*, ka të kryer 4 klasë të shkollës fillore, i pa punë, i martuar baba i 3 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomiko sociale, Shqiptarë, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R Ë

Sepse:

Më datën 23.03.2013, rreth orës 13:30, me qëllim vjedhje, në pyllin me të cilin qeverisë Autoriteti Pyjor i Kosovës-Zyra në Prishtinë, në vendin e quajtur “Gradina”, në Regjionin Ekonomiko Pyjor “Popovë”, KK Podujevë, , ka prerë dhe marrë 121 copë dru, dru të llojit bung e qarr ahu, me gjatësi prej 8 m, me diametër 12-14 cm, dhe me vëllim të përgjithshëm prej 4.56 m³, me ç`rast të dëmtuarës Autoritetit Pyjor të Kosovës-Zyra në Prishtinë, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej afër 410 euro,-

Sepse më datën 30.03.2013, rreth orës 14:40, në pyllin publik të quajtur “Lugu i Llapashticës”, në regjionin ekonomiko-pyjor Popovë, KK Podujevë, me të cilin menaxhon Drejtorja e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Podujevë, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit ti sjell përfitim pasurorë të kundërligjshëm, është zënë në flagrancë nga roja i pyllit duke prerë 272 copë trugje të llojit bungu, me sharrë motorike dhe traktor, me dimensione 8 metra, diametër 12-14 cm, me vëllim të përgjithshëm 5.40 m³, me ç`rast të dëmtuarës Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Podujevë, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej afër 486 euro,-

Sepse më datën 01.03.2013, rreth orës 15:20, me qëllim të vjedhjes, në pyllin me të cilin qeverisë Autoriteti Pyjor Komunal në Podujevë, në vendin e quajtur “Gradina”, në Regjionin Ekonomiko Pyjor të Popovës, duke prerë trugje, të llojit bungu-qam, të gjata 8 m, me diametër 12-14 cm, dhe me vëllim prej 5.03 m³, me ç`rast të dëmtuarës Autoriteti Pyjor Komunal në Podujevë, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej afër 452 euro,-

Sepse më datën 02.05.2014, rreth orës 16:00, në pyllin e pronësisë publike me të cilin menaxhon Agjencioni Pyjor i Kosovës, në vendin e quajtur “Segashë”, Regjioni Ekonomiko Pyjor i Popovës, Podujevë, i pandehuri B. B. pa leje të duhur e me qëllim vjedhje, duke përdorur mjetin e përshtatshëm sharrën motorike, ka prerë 33 copë trugje, të llojit ahu, me gjatësi 8-10 metra, me diametër 15-21 cm, , me vëllim të përgjithshëm prej 2.46 m³, me ç`rast të dëmtuarës Agjencionit Pyjor të Kosovës në Prishtinë, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej afër 376 euro,-

Sepse më datën 15.09.2014, rreth orës 15:30, në vendin e quajtur “Bellopojë”, në Rajonin Ekonomiko-Pyjor i Zllapushës, KK Podujevë, i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit ti sjell përfitim pasurorë të kundërligjshëm, ka prerë 20 copë trugje të llojit pishe -bagrem, me dimensione 9-16 metra të gjata, dhe diametër të ndryshëm 16-32 cm, me vëllim të

përgjithshëm 2.71 m³, me ç`rast të dëmtuarës Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Podujevë, i ka shkaktuar dëm material në vlerë afër 248 euro,-

Sepse më datën 08.02.2015, rreth orës 17:00, me qëllim të vjedhjes, në vendin e quajtur “Bellopojë”, Regjioni Ekonomiko Pyjor i “Zllapushë”, me të cilin qeverisë Komuna e Podujevës, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Sektori Pylltarisë me seli në Podujevë, ka prerë 6 copë trungje, të llojit pishë, të gjata 18 m, me diametër 32-40 cm, dhe me vëllim prej 3.74 m³, me ç`rast të dëmtuarës Sektori Pylltarisë me seli në Podujevë, i ka shkaktuar dëm material në vlerë afër 337 euro,-

Sepse më datën 06.02.2016, rreth orës 14:00, me qëllim të vjedhjes, në vendin e quajtur “Bellopojë”, Regjioni Ekonomiko Pyjor i “Zllapushë”, me të cilin qeverisë Komuna e Podujevës, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Sektori Pylltarisë me seli në Podujevë, ka prerë 4 copë trungje, të llojit pishë, të gjata 19 m, me diametër 24-40 cm, dhe me vëllim prej 2.80 m³, me ç`rast të dëmtuarës Sektori Pylltarisë me seli në Podujevë, i ka shkaktuar dëm material në vlerë afër 252 euro,-

- me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje pylli në vazhdim nga neni 358 par.2 dhe 358 par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4,7,17,41,46, 50, 51, 52, 73, 81 dhe 358 par.2 të KPRK-së, si dhe neni 365 dhe 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

Të pandehurin **B. B.**, e dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **4 (katër) muajsh**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej **1 (një) viti**, në qoftë se i pandehuri gjatë kësaj kohe nuk do të kryej veprë të re penale, si dhe me dënim me gjobë në shumë prej **700 Euro (shtatëqind euro)**, të cilin dënim obligohet ta paguaj brenda afatit prej tre muajsh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë brenda afatit prej tre muajsh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgim ashtu që për çdo 20 Euro, të papaguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burgim.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej **50 (pesëdhjetë) Euro**, brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara APK-Zyra në Podujevë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Publike Komunale tani Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzat PP.nr.2240/2013 e dt.25.06.2013, PP.nr.4173/2014 e dt.15.06.2015, PP.II.nr.1280/2015 e dt. 13.01.2016, PP.nr.3748 /2013 e dt.04.07.2013, PP.nr.2243/2013 e dt.25.05.2014, PP.nr.7699/14 e dt. 21.11.2014 PP/n.1138/16 e dt.18.03.2016, ka akuzuar të pandehurin B. N.B. nga fshati B., Komuna e P., për shkak se ka kryer veprën Vjedhje pylli nga neni 285 par.2 të KPK-së si dhe për veprën penale Vjedhje pylli nga neni 358 par.1 dhe par.2 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më dt.26.09.2016, gjatë së cilës u dëgjuan Prokurori i shtetit Fatmir Behrami nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe i pandehuri B. B..

Gjykata në fillim të shqyrtimit fillestar ka bërë bashkimin e procedurës penale për lëndët penale ndaj të pandehurit të cilat në gjykatë janë paraqitur në kohë të ndryshme, P.nr.599/2013, P.nr.652/2013,

P.nr.320/2014,P.951/2015, P.nr.633/2015 dhe P.nr.31/2016 dhe P.nr.434/2016 ashtu që tani e tutje procedura do të zhvillohet sipas lëndës më të vjetër P.nr.599/2013.

Gjykata ka konstatuar se i pandehuri në vazhdimësi ka kryer veprat penale Vjedhje pylli, pasi që janë kryer më shumë se dy vepra penale të llojit të njëjtë, se i ka kryer i njëjti person dhe të gjitha veprat penale janë kryer brenda një periudhe të shkurtë kohore dhe të gjitha veprat penale janë kryer me dashje, me çka të gjitha këto plotësojnë kushtet ligjore të parapara në nenin 81 të KPRK-së, për gjykim për veprat penale në vazhdim.

I pandehuri B. B., në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas të gjitha pikave të aktakuzës si dhe ka theksuar se më vjen keqe që mu ka dashur që të prej dru por kam qenë i shtyrë për të prerë malin për sigurimin e familjes sime, sepse nuk kam kurrfarë të ardhurash jetojmë në kushte shumë të vështira ekonomike- sociale , i premtoj gjykatës se kjo vepër nuk do të përsëritet më dhe lus gjykatën që ti marr parasysh këto rrethana dhe të merr vendim sa ma të lehtë.

Prokurori i Shtetit Fatmir Behrami nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, në fjalën e dhënë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, meqenëse i njëjti fajësinë e pranoj vullnetarisht dhe pas asnjë presion, njëheritë fajësinë e ka pranuar në pajtim me dispozitat e kodit të procedurës penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar gjyqësor, andaj Gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të akuzuarit, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Vjedhje pylli në vazhdim nga neni 358 par.2 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës, për çka edhe u shpallë fajtorë dhe i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari, gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ishte i sinqertë gjatë gjykimit, rrethanat e tij familjare dhe gjendjen e dobët ekonomike e sociale, faktin se është mbajtës i vetëm i familjes, premtimin se kjo vepër nuk do të përsërit veprën penale, duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana rënduese gjykata gjeti dhe pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë çështje penal-juridike. Andaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi zëvendësimin e dënimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 46 të KPRK-së

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalit gjyqësor u muar në bazë të nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.1. dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
P.nr.599/2013 më dt.26.09.2016

Gjyqtari:
Minir Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.